



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

Nr. 3199/1 Prot.

Tiranë, më 11.11.2025

V E N D I M

Nr. 60 datë. 11.11.2025

**“PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. ELTIONA METANI NË VENDIN
VAKANT PËR INSPEKTOR JOMAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I
LARTË I DREJTËSISË MË DATË 27.05.2024”**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Znj. Elena Pelushi - Kryetar
Znj. Lindita Ziguri – Anëtar
Znj. Joana Sorraj - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Eljona Bylykbashi
Znj. Zonje Shelqizi
Znj. Amanta Jasa

Në mbledhjen e datës 10.11.2025, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit për inspektor jomagjistrat: Znj. Eltiona Metani

OBJEKTI: Urdhërimi i lejimit të kandidimit të znj. Eltiona Metani, në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.

Komiteti pasi u njoh me aktet si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 27.05.2024, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 4 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 74, datë 26.06.2024 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 26.06.2024, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 02.07.2024, ku vendosi për shqyrtimin e dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistrat për pozicionin e inspektorit".
4. Znj. Eltiona Metani, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. nr. 1647 prot., datë 11.06.2024 për vendin vakant të Inspektor jomagjistrat pranë

Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë". Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 04.07.2024, kandidati, znj. Eltiona Metani është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatis i Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
6. Në datën 08.07.2024, kandidati znj. Eltiona Metani ka depozituar pranë sekretariatit teknik formularët e deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me shkresën nr. 2230 prot. datë 03.08.2024, i ka dërguar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve, që i nënshtrohen procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre.

8. Kandidati znj. Eltiona Metani e ka përmbushur detyrimin për të plotësuar në sistemin EACID dhe dorëzuar elektronikisht dhe fizikisht të plotësuar pranë ILDKPKI-së Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
9. ILDKPKI, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 199/23 prot, datë 10.01.2025, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e përfundimit të kontrollit të ushtruar për kandidatin znj. Eltiona Metani dhe personat e lidhur me të.
10. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, si dhe në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", ky institucion kryen verifikime pranë subjekteve publike dhe private që lejon ligji, të të dhënave mbi pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit znj. Eltiona Metani dhe personave të lidhur me të, si dhe administron/analizon të dhënat që dalin nga procesi i verifikimi të kriterit të pasurisë.
11. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit znj. Eltiona Metani referuar aktit të përfundimit të kontrollit të deklaratës së pasurisë rezulton se, ILDKPKI me shkresën nr. 199 prot., datë 07.08.2024 i është drejtuar me kërkesa për informacion lidhur me kandidatin znj. Eltiona Metani institucioneve: "Banka e Shqipërisë", Banka "Raiffeisen" SHA, "Banka Kombëtare Tregtare" SHA, Banka "Intesa Sanpaolo" SHA, Banka Tirana SHA, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka "ProCredit" SHA, Banka e Parë e Investimeve SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA, Banka "Credins" SHA, Banka Union SHA, Banka "OTP Albania" SHA, "Raiffeisen Leasing" SHA, Porsche Leasing SHA, RFZ Invest SHA, "Credins Invest" SHA, DPSHTRR, "Qendra Kombëtare e Biznesit", DPT, ISSH, D.P Detare, ASHK online.
12. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në mbështetje të nenit 209, pika 6, germa "a" dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit C, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Eltiona Metani ka depozituar diplomën nr. 8268 datë 30.06.2004, lëshuar

nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku vërtetohet se ka marrë titullin "Jurist". Kjo Diplomë, referuar nenit 124/2 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", ku parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), sipas parimeve të procesit të Bolonjës, është ekuivalente me diplomat "Master i shkencave".

13. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Eltiona Metani, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion edhe disa organeve ligjzbatuese, të cilët kanë kthyer përgjigjet përkatëse.
14. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me shkresën me nr. 2234 prot., datë 03.08.2024, sërish lidhur me integritetin është kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke verifikuar mbi plotësimin e kritereve të përcaktuara në pikën 1 të Kreut III dhe në zbatim të pikës 2, germa "b" Kreu V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Gjithashtu, në zbatim të kriterit të përcaktuar në pikën 6, germa "d" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, për verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit znj. Metani, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresën nr. 2235 prot., datë 03.08.2024, Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me verifikimin nëse ndaj kandidatit janë zhvilluar procese gjyqësore të karakterit penal, dhe nëse rezultojnë të dënuar, për efekt të gjendjes gjyqësore. Informacioni i kërkuar për sa më sipër, është përcjellë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 8904/1 prot., datë 14.08.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 13027/1 prot., datë 08.08.2024, të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve.
15. Për verifikim të mëtejshëm të kushteve të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si dhe në pikat 59 dhe 60 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, duke përcjellë formularin e vetëdeklarimit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të plotësuar nga kandidati jomagjistrat dhe ka kërkuar informacion për integritetin e kandidatit Eltiona Metani lidhur me ndonjë të dhënë apo indicie e ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje

me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, kopje të dokumentacionit që përmban të dhëna në rastet e identifikimit të kandidatit jomagjistrat në kontakte me persona të pa përshtatshëm. Informacioni i kërkuar për sa më sipër Prokurorisë së Përgjithshme, është përcjellë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 923/1 prot., datë 23.06.2025.

16. Në funksion të verifikimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i lartë i Drejtësisë, i është drejtuar me kërkesë për informacion lidhur me çështje gjyqësore apo hetime penale në ngarkim të kandidatëve, gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhe prokurorive pranë tyre, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe Prokurorisë së Posaçme, të cilët kanë kthyer përgjigjet përkatëse.
17. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, që kanë të bëjnë me përvojën profesionale si "Jurist", jo më pak se pesëmbëdhjetë vite punë në çastin e kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Arkivit Qendror me shkresën nr. 2232 prot, datë 03.08.2024, në lidhje me periudhën e derdhjes të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8503/1 prot, datë 09.08.2024, Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën nr. 8294/1 prot, datë 20.08.2024 dhe me shkresën nr. 18449/1 prot, datë 23.08.2024.

Me kërkesën nr. 2226 prot., datë 03.08.2024, kërkuar informacion Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Ministria e Mbrojtjes, lidhur me përshkrimin e hollësishëm të llojit të punës, kontratë individuale nëse ka, rregullore, akte që kanë të përcaktuar detyrat, ose përshkrim pune, për periudhën e punësimit pranë këtij institucioni, për periudhën 2008-2014. Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve në Ministrinë e Mbrojtjes, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1267/1 prot., datë 08.08.2024 protokolluar në ILD me nr. 2226/1 prot., datë 12.08.2024, duke vënë në dispozicion urdhrat e emërimit, kontratat individuale të punës, rregullore të brendshme të institucionit.

18. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të parashikuar në nenin 209, pika 6, germa "ç", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të vendimit nr. 536, date 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", u

vlerësua t'i drejtohem me kërkesë për informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë me nr. 2238 prot., datë 03.08.2024 duke kërkuar nëse kandidati, në mënyre aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit. Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjigjur me shkresën nr. 350 prot., datë 04.09.2024.

19. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe pikës 62, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit nëse kandidati, përfshihet në rastin e posaçëm të nenit 209, pika 6, germa "e", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar: "e) *ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991*" apo në njërin nga rastet e pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë." Me shkresën nr. 2231 prot, datë 03.08.2024, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.
20. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1312/3 prot, datë 20.08.2024 ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin, i cili është bashkëngjitur praktikës së kandidatit (*Vendim nr. 501, datë 20.08.2024* i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit).
21. Në vijim të procedurave të verifikimit që lidhen me integritetin e kandidatëve për inspektorë jomagjistratë si dhe për të shmangur çdo lloj konflikti interesi që bie ndesh me nenin 209, pika 6, germa "dh", "ë" dhe "f" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, është njoftuar zyrtarisht kandidati që të plotësojë formularët përkatës që lidhen me:
- mospasjen e funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
 - mosqenien bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
 - mosqenien anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.
- Për sa i takon kandidatin znj. Eltiona Metani, është paraqitur në ambientet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ka dorëzuar të plotësuar secilin prej formularëve të mësipërm.

22. Gjithashtu në funksion të verifikimit sipas germave "dh" dhe "f", është proceduar edhe me kërkim informacion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e cila ka kthyer përgjigjet përkatëse sipas shkresës me nr. 3572/1, datë 13.06.2025.
23. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 27 e vijues, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Kryetari i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 10.11.2025, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit të kandidimit të znj. Eltiona Metani, për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komitetit

24. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatit znj. Eltiona Metani për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
25. Në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, konkretisht në nenin 209, në pikën 6, përcaktohen "Kushtet për inspektor jomagjistrat", prej nga rezulton se:

Kandidatët për inspektorë, të cilët nuk janë magjistratë, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;
- b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;
- c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;

- ç) në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;
- d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- e) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991;
- ë) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
- f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

26. Përsa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar nga ana ILDKPKI-së, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 199/23 prot, datë 10.01.2025, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin znj. Eltiona Metani dhe personat e lidhur me të.

27. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit, znj. Eltiona Metani, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

28. Pra, mbi bazën e verifikimeve të kryera nga organi përgjegjës, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve arrin në përfundimin se hetimi i thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI janë të plota dhe shteruese sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, lidhur me kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit znj. Eltiona Metani.

29. Për këto arsye, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e

Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti vjen në përfundimin se kandidati znj. Eltiona Metani "kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij". Për rrjedhojë, për sa më sipër, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

30. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të *"a) të jetë shtetas shqiptar me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare,"* nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati znj. Eltiona Metani ka depozituar diplomën nr. 8268 datë 30.06.2004, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku vërtetohet se ka marrë titullin "Jurist". Kjo Diplomë, referuar nenit 124/2 të ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, ku parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), sipas parimeve të procesit të Bolonjës, është ekuivalente me diplomat "Master i shkencave". Për rrjedhojë kandidati znj. Eltiona Metani nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitës së sipërcituar.
31. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "b" të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale"*, nga aktet e administruara në dokumentacionin e aplikimit si dhe bazuar në rezultatet e arritura nga kandidati në shkollë të lartë ku ka fituar titullin "Jurist", kandidati, znj. Eltiona Metani, e plotëson këtë kriter.
32. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "b" e "d" të ligjit nr. 115/2016, *b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale"* dhe *"të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi"*, nga aktet e administruar nga Organet ligjzbatuese, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme, zyrat e prokurorive dhe gjykatave ka rezultuar se nuk ka të dhëna që të ketë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, apo të dhëna të tjera në funksion të parashikimeve në nenin 2 të ligjit nr. 138/2015, *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, si dhe të dhëna të vlerësuar për verifikimin e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, *"Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*, referuar parashikimit të pikës 79 të

vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *"Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit"*.

Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretime të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

33. Për rrjedhojë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese dhe institucione të tjera kushtetuese të lartpërmendura, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "b" dhe "d" të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.
34. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *"c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet"*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë diplomën/kualifikimet, jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati znj. Eltiona Metani ka ushtruar veprimtari profesionale si:
- Avokat, Zyrë Avokatie Eltiona Metani, për periudhën 08 janar 2008 -01 tetor 2008;
 - Specialist në Sektorin e Hartimit të Prioriteteve të Licencimit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për periudhën 01 tetor 2008 - 29 dhjetor 2011;
 - Specialist në Sektorin e Regjistrimit dhe Kontrollit të Përputhshmërisë, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për periudhën 29 dhjetor 2011-25 shkurt 2014;
 - Drejtor, Drejtoria e Legjislacionit dhe Përfaqësimit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, për periudhën 25 shkurt 2014 deri në momentin e aplikimit.
35. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër, Komiteti konstaton se kandidati znj. Eltiona Metani ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga neni 209, pika 6, germa "c" e ligjit nr. 115/2016. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
36. Për sa i përket urdhërimeve të nenit 209, pika 6, germa "ç", të ligjit nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"*, të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV,

të Vendimit Nr. 536, date 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", ku kërkohet që kandidati për inspektor jomagjistrat, të mos ketë ushtruar në mënyre aktive, profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit është kthyer përgjigje nga Dhoma Kombëtare të Avokatisë me shkresën nr. 350 prot., datë 04.09.2024. Në bazë të kësaj përgjigje rezulton se znj. Eltiona Metani, ka licencë me nr. 2718, në vitin 2006 dhe me status pasiv për periudhën 2009-2024. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

37. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "dh", "e", "ë" dhe "f", të ligjit nr. 115/2016, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Eltiona Metani, në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si dhe atë të mbërritur nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
38. Në nenin 209, pika 6, gjerat "dh" dhe "f" të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët "dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit" dhe "f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit". Për verifikimin e këtyre kushteve për kandidatin në fjalë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar informacion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr. 1566 prot., datë 21.05.2025 lidhur me verifikimin në regjistrat elektronik që mban gjykata për të dhënat që kanë të bëjnë me mbajtjen e pozicioneve drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit, duke filluar nga data 27.05.2024, si dhe me anëtarësinë në organet drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit duke filluar nga data 27.05.2024.
39. Bazuar në kthimin e përgjigjes së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr. 3572/1 prot., datë 13.06.2025, si dhe referuar formularit të vetëdeklarimit, kandidati Eltiona Metani nuk rezulton të ketë mbajtur funksione politike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit apo të jetë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata në kohën e kandidimit. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit sipas germave "dh" dhe "f", të pikës 6, të nenit 209 të ligjit me nr. 115/2016.
40. Në nenin 209, pika 6, germa "e" të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët "e) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991". Për verifikimin e këtij kriteri për kandidatin në

fjalë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit tek Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, formularin e aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta" të parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të plotësuar nga kandidati.

41. Në përgjigje të kërkesës tonë, është administruar vendimi nr.501, datë 20.08.2024 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, nga ku rezulton se, kandidati znj. Eltiona Metani:

- Për shkak të moshës nën 14 vjeç, para datës 02 korrik 1991, nuk është subjekt verifikimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2015 *"Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i ndryshuar*.

Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e" të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

42. Në nenin 209, pika 6, germa "ë" të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët *"të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret"*; e për këtë qëllim është dorëzuar dhe nënshkruar nga kandidati deklarata me anë të së cilës kandidati deklaroi se nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi sekret më datë 09.07.2024. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshi këtu dhe formularin e vetëdeklarimit në dosjen e kandidimit, Komiteti konstaton se kandidati znj. Eltiona Metani, nuk rezulton të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi sekret, në kohën e kandidimit. Për rrjedhojë, kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

43. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet me sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jomagjistrat, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit znj. Eltiona Metani, në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024, pasi kandidati plotëson të gjitha kriteret parashikuara në nenin 209, pika 6, të ligjit nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"* të ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *"Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit"*.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 27 e vijues të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:


VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit znj. Eltiona Metani, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit znj. Eltiona Metani.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR

Lindita Ziguri



KRYETAR

Elena Pelushi



ANËTAR

Joana Sorraj

